



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / UROŠEVAC



16.02.2015

C.nr.515/12

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm-Civil me gjyqtari Enes Mehmeti, me bashkëpunëtorin profesional, Alban Beqiri, në çështjen juridike të paditëses [redacted] Sheshi [redacted] - [redacted] kundër të paditurit, [redacted] nga fsh. [redacted] Komuna e [redacted], për kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 6.698,50 €, jashtë seancës publike më 16.12.2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET kërkesë padia e paditëses, [redacted] si e pabazuar

DETYROHET paditësja që ti paguan shpenzimet e procedurës në shumë prej 100€ në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë

A r s y e t i m

Paditësja, [redacted] Sheshi [redacted] në këtë gjykatë me dt.01.10.2012, ka ushtruar padi për kompensim demit ndaj të paditurit [redacted] nga fsh. [redacted] Komuna e [redacted]

Gjykata pas shqyrtimi paraprak të padisë me dt.20.11.2014 ka marr aktvdenim për përgjigje në padi.

Pasi që kërkesë padia e paditëses është kundërthënë me faktet e treguara në padi, e cila shihet edhe në dispozitivin e aktgjykimin P.nr.723/07 të datës 29.06.2012 të Gjykatës Komunale në Ferizaj me të cilin është shpallur fajtor i padituri nuk është vërtetuar se shumën e kërkesë padisë së paditëses e ka përvetësuar, por të njëjtat vetëm i ka përdorur pa autorizim për një kohë të caktuar.

Andaj, siq shihet I padituri nuk e ka përvetësuar shumën që është objekt I kësaj çështje juridike-civile me të cilën do ta kishte dëmtuar paditëses që të kërkonte me padi kompensimin e demit.

Andaj gjykata bazuar në nenin 399.2 lidhur me par.I të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së në të cilat shpenzime është llogaritur taksa gjyqësore për padi prej, 50 € dhe aktgjykim prej, 50 €, gjithsej në lartësi prej 100 €.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr. 515/12 më dt.16/12/2014



Gjyqtari:
Enes Mehmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.